

**Pranvera DIBRA-TELI**

## **AT GJERGJ FISHTA PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS, 1919-1920**

Në kompleksitetin e figurës së At Gjergj Fishtës, kontributi ndaj çështjes kombëtare shqiptare mbetet një konstante e përhershme e veprimtarisë së tij si njeri i letrave, publicist, klerik e politikan. Duke mos u mbyllur në guaskën e një frati të thjeshtë, At Fishta vuri në shërbim të kombit: fuqinë e penës, aftësinë e tij oratorike e argumentuese, arsenalin e tij kulturor e respektin që gëzonte te personalitetet jashtë vendit. Si i tillë ai do të vlerësohej vazhdimisht nga qarqet e ndryshme intelektuale brenda dhe jashtë vendit: *“Kudo që ishte për t’u rrahë çështja e Shqipërisë, - shkruante Petrotta te “Hylli i Dritës” në 1931, - At Gjergj Fishta gjendej aty pranë, e ku me shkrime, sidomos me poezinë e gjallë të veten, çoi prej gjumit ato të ma të plogshtit e mbante gjallë gjithmonë shpresën e t’ardhmes së atdheut”*.<sup>1</sup>

Një ndër momentet kyç të historisë së trajtimit të çështjes kombëtare shqiptare në fillim të shekullit XX është Konferenca e Paqes e Parisit, më 1919-1920. Lufta e Parë Botërore, si përfundim i krizës lindore, solli një realitet të ri në raportet mes shteteve. Mbështetësja më e madhe e pavarësisë së Shqipërisë, Perandoria Austro-Hungareze, nuk ishte më. Në Ballkan tashmë ishte krijuar Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene (SKS), që konkurronte me Italinë

---

<sup>1</sup> G. Petrotta, Popolo, *Lingua e Letteratura Albanese*, Palermo 1931, revista “Hylli i dritës”, tetor 1931, nr. 10.

fqinje në pretendimet e tyre territoriale ndaj Shqipërisë londineze të vitit 1913. Nga ana tjetër, në sfondin e marrëdhënieve ndërkombëtare tani shfaqet SHBA-ja si mbrojtëse të popujve të vegjël dhe e së drejtës së tyre për të vendosur vetë për fatet e tyre politike, duke mos u bërë viktima të kompromiseve mes Fuqive të Mëdha. Këtë parashitje presidenti amerikan U. Uillson në 14 pikat e programit të tij të shpallur në vitin 1918, para fillimit të punimeve të Konferencës. Te ky vizion i ri shpresonin shumë edhe shqiptarët e përfaqësuesit e tyre në Konferencën e Paqes, por vizioni uillsonian do të përplasej në Konferencë me mentalitetin tradicional të fuqive të mëdha europiane për mënyrën e të bërit paqe mes tyre.

Në Shqipërinë e 1913-ës, pas Luftës së Parë Botërore, mbretëronte kaosi, pasi territoret e saj kishin shërbyer si fushëbeteje e fuqive ndërluftuese. Një pjesë e territoreve të saj ishin ende të pushtuara nga ushtritë e shteteve fqinje, aleate të Antantës, ndaj fati i tyre do të diskutohej sërish në Konferencë dhe rrezikonin të përdroreshin si monedhë shpërblimi për aleatët ballkanikë të Fuqive të Mëdha fituese, ose pjesë e kompromiseve të zakonshme të shteteve europiane në Ballkan.

Roma zyrtare, sipas premtimeve që i ishin bërë në Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915, kërkonte Vlorën dhe protektoratin mbi shtetin autonom shqiptar, që do të formohej në Shqipërinë e Mesme, por synimet e Italisë përplaseshin me interesat e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, e cila si kundërpeshë, kërcënonte se do të dilte me pretendime të reja mbi Shqipërinë politike të 1913-ës, duke kërkuar veriun e saj. Qeveria greke kërkonte aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës, duke iu referuar Traktatit të Fshehtë të Londrës, ku Italia ia njihte asaj të drejtat në Shqipërinë e Jugut. Në këto rrethana të vështira ndërkombëtare kërkoheshin që shqiptarët të prezantoheshin sa më denjësisht e me përgjegjësi të lartë kombëtare në këtë Konferencë. Në këtë atmosferë të turbullt u mbledh Kongresi Kombëtar në Durrës, menjëherë në përfundim të luftës (25.12.1918). Ky kongres vendosi për formimin e Qeverisë së Përkohshme të Durrësit dhe caktoi edhe delegacionin që do të përfaqësonte qeverinë në Konferencën e Paqes

në Paris. Ky delegacion do të prezantonte kërkesat legjitime për kufijtë kombëtarë të territoreve shqiptare, duke korigjuar edhe gabimet e bëra në Kongresin e Berlinit më 1878 dhe në Konferencën e Londrës më 1913. Delegacioni do të drejtohej nga kryetari i qeverisë, Turhan pashë Përmeti, dhe do të përbëhej nga Imzot Bumçi, Luigj Gurakuqi, dr. Mihal Turtulli, Mehmet Konica dhe Mithat Frashëri.<sup>2</sup>

Edhe në këto momente delikate, ku fatet e kombit ishin vënë në balancën e ekzistencës, At Gjergj Fishta do të jetë i pranishëm me mënyrën e tij origjinale. I njohur për përkushtimin e tij ndaj çështjes kombëtare, për të cilën ai kishte dhënë prova, i spikatur si një françeskan i njohur në Europën kristiane, pa mohuar gjithashtu edhe miqësinë e ngushtë dhe bashkëpunimin e gjatë me Imzot Luigj Bumçin, At Fishta në Shkodër më 27 janar 1919 merr një ftesë nga Qeveria e përkohshme e Durrësit, për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes në Paris, si pjesë e delegacionit shqiptar. Në ftesë thuhej: *“Tuj çmu cilësitë fisnike të mendjes e të zemrës suej, e meritimet e nalta qi keni fituem me veprën tuej patriotike, Qeveria e përkohshme ju ka emnuem ekspert të delegatsis shqiptare që do të mbrojë të drejtat e kombit tonë në Konferencën e Paqes mbi parimin e një Shqipnie të lirë e te pavarur mbrenda kufijve etnikë të saj. Ju lutemi qi ta pranoni këtë barrë e të niseni bashkë me delegatin Imzot Luigj Bumçi për tu bashkue me shokët e tjerë”*.<sup>3</sup>

At Gjergj Fishta e pranoi ftesën dhe mori pjesë në delegacionin qeveritar, në fillim në pozitën e ekspertit. Pas zëvendësimit të Turhan pashë Përmetit me Imzot Bumçin (më 28 qershor 1919) në krye të delegacionit, ky i fundit e merr Atin si “sekretar personal” të tij.<sup>4</sup> Duhet theksuar se të qenët klerik françeskan e favorizoi shumë praninë dhe përpjekjet e tij në qarqe të ndryshme. At Fishta diti ta

<sup>2</sup> Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I, Toena, Tiranë 2013, 370.

<sup>3</sup> Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), F. 149, V. 1919, D. I-1860, letër Qeverisë së Durrësit për At Gjergj Fishtën, 27. I. 1919.

<sup>4</sup> Revista “Hylli i Dritës”, viti 1934, nr. 5, 220.

shfrytëzonte këtë mundësi për të mbështetur trajtimin e drejtë të çështjes shqiptare në Konferencë.

Delegacioni qeveritar mbërriti në Paris në fillim të prillit 1919. Atje ata takohen me delegacione të tjera të diasporës shqiptare, ku secili përfaqësonte variantin e vet në mbrojtjen e çështjes kombëtare. Qeveria e Përkohshme e Durrësit nuk ishte e njohur ndërkombëtarisht, ndaj delegacioni i saj nuk merrte pjesë me të njëjtin status si delegacionet e tjera në Konferencë. Përpjekjet e delegacionit qeveritar më së shumti u zhvilluan jashtë sallës së Konferencës, në komisione të veçanta, me takime, lobime e peticione për të ushtruar tryzni e për të gjetur përkrahje për trajtimin e drejtë të çështjes shqiptare. Pavarësisht përpjekjeve, gjatë zhvillimit të seancave të Konferencës, memorandumëve dhe peticioneve nga krahinat e rrezikuara shqiptare dhe nga vetë delegacionet e pranishme në Paris, ato nuk po merrreshin parasysh dhe trevat shqiptare po trajtoheshin si monedhë këmbimi mes fuqive të interesuara në rajon dhe aleatëve të tyre ballkanikë. Në kuadrin e përpjekjeve që bënë të gjitha delegacionet për sigurimin e mbështetjes për çështjen shqiptare, At Gjergj Fishta dhe Imzot Bumçi, nga ana e tyre me intuitën e kohës, menduan të ndjekin edhe një rrugë tjetër: atë të ndikimit të qeveritë e Fuqive të Mëdha, nëpërmjet autoriteteve kishtarë, miqve dhe dashamirësve të Shqipërisë në këto shtete.

Në mars 1919, rrugës për të mbërritur në Francë, Fishta u ndal në Romë bashkë me Imzot Luigj Bumçin dhe parashtroi para autoriteteve kishtarë të Vatikanit kërkesat në mbrojtje të integritetit territorial dhe pavarësisë së Shqipërisë të vendosur në 1913-ën. Në telegramin dërguar At Pal Dodës nga Parisi më 17 prill 1919 Fishta shprehet për këtë vizitë: *“Në Romë fola me Kryetarin e Urdhnit të Fretënve, At Serafino Cimino rreth gjanave tona në Shqypni. Ishte shumë i gatshëm për ne. Mes të tjerave na tha që ai s’na mbante aspak përgjegjës për atë që mund të ndodhte në konferencat ndërkombëtare. U interesue shumë edhe për kërkesat e shqiptarëve. Interes të madh për qëllimin tonë kallxoi dhe Papa Benedikti XV, i cili na urdhnoi të ktheheshim në Rome për t’i referue për shkuemjen tonë*

në Paris.”<sup>5</sup> Për këtë vizitë, ku delegatë ishin Luigj Bumçi, At Fishta dhe Mehdi Frashëri, e përditshmja franceze “Paris-Midi” më 16 mars 1919 do të shkruante: *“Këta delegate të rinj, që gjatë audiencës së Papës në Romë, morën miratimin e Atit të Shenjtë, afirmojnë në këtë konferencë bashkimin e ngushtë të të krishterëve në Shqipëri me myslimanët në lidhje me kërkesat e tyre kombëtare”*.

Ishte ky personalitet, Papa Benedikti XV, që pas takimit në fund të 1919-ës me Imzot Luigj Bumçin i premtoi atij se do të bënte ç’ ishte e mundur për shpëtimin e dy krahinave të rrezikuara të Korçës dhe të Gjirokastrës, nga Traktati *Titoni-Venizellos*, 29 korrik 1919, duke biseduar me përfaqësuesit e qeverive angleze e amerikane<sup>6</sup>. Vatikani nuk kishte marrëdhënie fort të mira në atë kohë me qeveritë në Itali e Francë. Ai ishte shumë i interesuar për Shqipërinë, pas përfundimit të protektoratit të kultit të Austro-Hungarisë në Shqipëri në përfundim të luftës.

Ndërkohë, takimet me personalitete me ndikim brenda dhe jashtë Konferencës vazhdonin. Ndër ta spikat ai që u zhvillua ndërmjet Imzot Bumçit, At Gjergj Fishtës e kardinalit të famshëm të Brukselit, Desidre Mercier, primat i Belgjikës. Shqipëria kishte nevojë për përkrahje. Në telegramin e 13 shkurtit 1920, që At Gjergj Fishta i dërgon Padër Lorencit e gjithë fretërve të kuvendit në Shkodër, ai shkruan: *“...Kardinali Mercier na priti me njerzi e dashtni të madhe. Ai e muer për zemër çështjen tonë e tha se ka me i shkruie për këtë punë Balfurit, kardinalit të Londonit, Marshallit Fosh Dechanelit, Milerandit etj.”*<sup>7</sup> Të gjithë përfaqësonin personalitete me ndikim për kohën. Në mbledhjet e delegacionit të Qeverisë së Durrësit, At Fishta këmbëngulte për një koordinim të vazhdueshëm të qëndrimeve të anëtarëve të delegacionit me udhëzimet nga Qeveria e Durrësit. Sipas Fishtës, në këtë mënyrë do të shmangeshin ngatërresat mes anëtarëve

<sup>5</sup> Pal Dodaj, *At Gjergj Fishta në Konferencën e Parisit*, tek At Gjergj Fishta 1871-1940, *Distapur*, Tiranë 1943, 111.

<sup>6</sup> Revista “Hylli i dritës”, v. 1934, nr. 5, 221.

<sup>7</sup> Pal Dodaj, *At Fishta në Konferencën e Paqes*, 115.

të delegacionit dhe e kundërta: *“Do të dilte vetëm për fitim të serbëve dhe të grekëve”*.<sup>8</sup> Sidoqoftë, shpesh ndeshte rezistencën e ndonjë anëtari të delegacionit për këtë metodologji pune.

Në rolin e sekretarit të dërgatës, Fishta tregohet i gatshëm të punojë fort për mbajtjen e kontakteve dhe dërgimin e mesazheve të delegacionit qeveritar në Paris miqve të Shqipërisë jashtë Francës, si dhe institucioneve të ndryshme me ndikim. Në një letër të At Gjergj Fishtës, të botuar te revista *“Hylli i dritës”* në vitin 1993, të lënë në harresë jo pa qëllim nga diktatura komuniste, shkruar nga Londra më 1 nëntor 1919, e cila i drejtohej Imzot Bumçit, At Fishta vë në dijeni Bumçin për misionin e tij në Londër, për të siguruar përkrahjen e nevojshme që i duhej Shqipërisë nëpërmjet takimeve me prelatë të huaj katolikë e me personalitete politike. Mes të tjerave ai shkruan: *“...T’ë nesërmen që mbrrina në London shkova menjëherë te famullitari i mëhallës ku rri Preka (një shqiptar patriot) dhe e pyeta për kardinalin. Famulltari i cili flet pak frengjisht u interesue menjëherë për këtë punë, por mjerisht kardinali nuk gjindet tash për tash në London. I ka shkruar sekretarit të tij e sot pret përgjigje. M’kanë thanë edhe se do të përkujdeset me më pjekë me t’amën e Dukës Norfolk, tu kenë se duka është ande fmi. As miss Durhami, as kolonel Erbert për tash s’gjinden në London... Mjaft keq po më vjen që s’po kam se si me u nisë për Amerikë, pse me kët hov që kam marrë, dru se kam kenë tue kapërcye n’Japan.”*<sup>9</sup>

Ndërkohë që At Fishta ndodhej në Londër, ai ishte zgjedhur nga delegacioni që të udhëtonte në Amerikë për të zhvilluar takim në Komisionin e Punëve të Jashtme të Senatit Amerikan për të paraqitur kërkesat e përfaqësuesve të Shqipërisë në Konferencë, por kjo nuk u realizua për arsye teknike. Në korrespondencën e delegacionit të Qeverisë së Durrësit me përfaqësuesit e diasporës shqiptare në Zvicër,

<sup>8</sup> Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme (AMEPJ), v. 1919, D. 17, 89-90, letër e delegacionit qeveritar në Paris drejtuar Mithat Frashërit në Zvicër, 19 korrik 1919.

<sup>9</sup> Revista *“Hylli i dritës”*, v. 1993, nr. 1, 49.

tetor 1919, lexojmë: *“Ndonëse lypsej ta kuptonim se nga SHBA-ja Shqipnia nuk mund të priste ma tepër se një ndihme morale dashamire, megjithatë në muajin gusht i paraqitem një thirrje Senatit Amerikan, kur morëm vesh se komisia e Punëve të Jashtme të këtij senati do të pranonte përfaqësuesit e kombeve të sakrifikume për të paraqitur dëshirat e veta, ndaj vendosëm dërgimin e At Gjergj Fishtës për këtë qëllim në Uashington. Në ditët e para ky nuk mundi me gjet biletë për në vapor, ma vonë të shkumit e tij u bë i panevojshëm, mbasi komisia e Senatit priti nga ana e Shqipnisë zotërinjtë Dako, Chekrezi dhe Erickson, dhe më pas u dha fund pritjeve të kësaj dore.”*<sup>10</sup>

Nga i gjithë letërkëmbimi i Fishtës kuptohet qartë, se kontaktet me kolegët e tij në Shkodër ishin të vazhdueshme. Ai informonte vazhdimisht për të rejat nga Konferenca, ku jo vetëm që të mbante gjallë shpresën dhe optimizmin, por edhe për të nxitur kërkesat e vazhdueshme të popullsisë ndaj Konferencës. Informacionet e përcjella janë të larmishme: njohjet me projektet e ndryshme të paraqitura nga Fuqitë e Mëdha për copëtimin e Shqipërisë, pretendimet e fqinjëve, si dhe qëndrimin e delegacionit shqiptar ndaj tyre.

Më 27 qershor 1919, Luigj Bumçi, Gjergj Fishta dhe Luigj Gurakuqi i dërguan nga Parisi episkopit katolik në Shkodër një telegram, në të cilin thuhej: *“Jugosllavët po i shumëfishojnë përpjekjet e tyre pranë Konferencës për të aneksuar Shkodrën, bregun e djathtë të Drinit, Lezhën e Mirditën. Prandaj është tepër e rëndësishme, që me shpejtësi t’i silllet Konferencës nga ana e klerit katolik një proteste energjike kundër pretendimeve të tilla, duke deklaruar se elementi katolik shqiptar dëshiron të qëndrojë në kuadër të Shqipërisë së pavarur”*.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> AMEPJ, v. 1919, D. 17, fl. 196, *Korrespondencë e delegacionit qeveritar*, 24 tetor 1919.

<sup>11</sup> Pal Dodaj, *At Fishta në Konferencë...*, 112.

Pak muaj më vonë ai shkruante: *“Gjatë javës së s’kalueme, u pritëm shkurt nga Uillon-I, i cili fatmirësisht na dërgoi pastaj te një sekretar i tij për me hartue një raport mbi çështjen. Mbresa e marrun ishte shumë e mirë. Duket se në kufitë e Londrës (1913) mund të shpresojmë. Për Shkodrën nuk ka rrezik...”*<sup>12</sup> Ai informon edhe për rezultatin e punës së kryer, për faktin që në parlamentin italian grupi katolik kishte kërkuar nga Niti (kryeministër i sapoemëruar), që Italia të mundësonte me të gjitha mënyrat që të copëtimi i Shqipërisë të mos ndodhte. Përpjekjet ishin të gjithanshme. Shpesh jepeshin udhëzime për koordinimin e veprimtarisë dhe për petitionet e telegramet, që elementi katolik shqiptar duhej t’i drejtonte Konferencës për të protestuar mbi ndarjen e Shqipërisë e të deklaronte para Europës se myslimanë e katolikë shqiptarë janë vëllezër.<sup>13</sup>

Një ndër monumentet e mendimit të thellë filozofik, atdhetar, historik dhe argumentues të Fishtës është dhe punimi i paraqitur nga Imzot Bumçi në auditorin e Universitetit Katolik të Parisit, me kërkesën e rektorit të këtij universiteti gjatë kohës së qëndrimit në Paris, ku At Fishta kishte kontribut të spikatur në hartimin e tij. E mbajtur gjatë kohës së Konferencës së Parisit, edhe pse në një mjedis jashtë sallës së Konferencës, ky punim, në thelb, merr përsipër të hedhë poshtë pretendimet dhe tezat e paraqitura për të argumentuar padrejtësitë që po i bëheshin popullit shqiptar. Punimi i përbërë nga 29 faqe përshkohet nga pikëpamjet dhe argumentet në favor të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve, pa munguar dhe mendimi i tij për rrugën e zgjidhjes së çështjes shqiptare. Duke marrë shkak nga diskutimi i problemit të ripërcaktimit të kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Paqes, Imzot Bumçi dhe At Fishta japin një panoramë të shtrirjes së trevave etnike shqiptare, duke mohuar ndarjen e padrejtë të 1913-ës. Mbështetur në parimin e Presidentit Uillon, që për “vetëvendosjen e popujve, përveç kombësisë, do të merrej parasysh edhe vetëdija e tyre kombëtare”, në material argumentohet se: *“...në qoftë se për*

<sup>12</sup> Po aty, 113.

<sup>13</sup> Po aty, 116-117, dhe revista “Hylli i dritës”, v. 1934, nr. 1, 41.

*ndërgjegje kombëtare do të merrej ndjesia e lirisë e dëshira për t'u zhvillue në vetvedi, un tham se Konferenca do t'ia njohë Shqypnisë pamvarësinë e syperanin e vet, se askush si shqiptari s'e ka mbështet gjithë shpresën e ndjenjës e lirisë në fuqi të vetë e m'atë të armëve të veta, e se deri më sot nuk i asht përulë ndonjë force të huej. Kjen, po, pushtuesa mbi Shqypninë, por nuk kjenë kurrë zotnuese mbi shqyptarët."*

Më tej Fishta e Bumçi, me argumente dhe me arsyetim logjik, hedhin poshtë pikëpamje të tilla *"...që shqiptarët s'mund të jenë shtet më vete, se ata janë barbarë, nuk janë të zot me përparue e qytetnue krejt të pavarur, ndaj duhet të copëtohen që të vihet rregull"*. Ata argumentojnë se populli shqiptar është një popull me aftësi të njëjta shtetformuese, duke sjellë raste analoge me historinë e popujve të tjerë, të cilët tashmë kishin shtetin e tyre. Por, sipas Fishtës, për veçoritë e tij historike, duke qenë gjithmonë i pushtuar nga të huajt, dhe jo se i mungonte ndërgjegjja kombëtare, populli shqiptar deri vonë nuk arriti të dilte në arenën europiane me njësinë e vet shtetërore. Po ashtu, gjakmarrja, shpesh e përdorur si shenjë treguese për barbarinë e shqiptarëve, sipas Fishtës, nuk është shenjë egërsie dhe ashpërsie e shpirtit të shqiptarit, as instinkti i tyre, por ajo buron prej *"...ndarjeve të ndikuara prej ligjeve të jashtme e prej të metave të organizimit shoqëror të një kombi e jo gjithmonë prej gjendjes së tij shpirtërore..."*

Në përfundimin ai flet për të drejtat e shqiptarëve, ku si kryesore cilëson dy prej tyre: *pavarësinë politike e ekonomike dhe kufijtë gjeografike e etnografike të Shqipërisë*. Për pavarësinë e Shqipërisë, ai merr të pandryshuar statusin e Shqipërisë të njohur nga Konferenca e Londrës, ndërsa për kufijtë gjeografikë të një shteti, sipas Fishtës e Bumçit, *"nuk duhej gjykue mbi gjendjen e atëhershme të Shqipërisë, ku pushtimet e hueja e intrigat ia kishin përcundnue fizionominë gjeografike e etnografike. Ndaj një shtet gjeografikisht do të përshtrihej deri ku të kapte kombësia e pandame, e vijue e atij populli. E në rast se ndonjë skundill toke të këtij shteti gjinden të shartuem elemente të hueja, aty vullneti i popullit do të vërtetohej*

*nëpërmjet një plebishiti, lirija e të cilit të jetë e dorzuanueme e sigurueme si duhet dhe sa duhet...”, duke aluduar kështu kundër vendimit të Konferencës, për ta lënë caktimin e kufijve jugorë në dorë të Komisionit Ndërkombëtar, sipas vendimeve të Konferencës. Ai konkludon me thënien e Rusoit, se “ për fatet e një populli duhet pyetur më parë vetë populli”<sup>14</sup>*

Duke u bashkuar tek ai shkrintari dhe atdhetari, Fishta i shpreh përjetimet e veta në Konferencën e Paqes edhe nëpërmjet vargjeve të tij të fuqishme<sup>15</sup>:

*N’at Paris-sadome fillgshtije,  
T’mdhejt e botës e kan plegnue,  
Hasmëve t’uej me u ba juve flije,  
Si ata Zoti i past marrue!  
Por mos drueni, mbi tokë dhuna,  
Tepër gjatë kurrë s’mund t’vazhdoj,  
Tashë ecë moti, tash ndron puna,  
Prap shqyptari i lirë do t’rrojë.*

Në përfundim mund të themi se Fishta u përpoq vazhdimisht ta pasurojë pa u lodhur veprimtarinë e tij të gjithanshme me kontributin ndaj çështjes kombëtare shqiptare, kontribut i pranishëm edhe në aktivitetin e delegacionit të Qeverisë së Durrësit në Konferencën e Paqes, Paris 1919, duke shfrytëzuar me mençuri të gjitha mundësitë që i ofronte pozita e tij shoqërore, arsenali i kulturës historike, forca e argumentit dhe e penës, pavarësisht nga pozicioni që mbante në delegacion. Ky kontribut, së pari, ishte mbështetja morale e shpirtërore për të gjitha përpjekjet e bëra nga nacionalistët shqiptarë për Shqipërinë dhe çështjen shqiptare; së dyti, kontributi për të siguruar përkrahjen e nevojshme për të mbështetur kërkesat dhe të drejtat e shqiptarëve nëpërmjet takimeve me klerikë të huaj katolikë,

<sup>14</sup> Filip Fishta, *Antologji e Shqipërisë*, Tiranë 1936, 6, Fishta “Shqiptarët dhe të drejtat e tyre”.

<sup>15</sup> Gjergj Fishta, *Epopeja e fisit shqiptar*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër 1920.

personalitete të larta kishtare e miq të Shqipërisë, figura me ndikim pranë kancelarive për kohën; së treti, mbajtja e lidhjeve dhe koordinimi i veprimtarisë dhe i qëndrimeve mes delegacionit qeveritar në Paris, qarqeve të caktuara atdhetare në Shqipëri e miqve jashtë saj, që punonin për ta mbështetur atë. Si i tillë ky kontribut duhet vlerësuar, për t'i dhënë Fishtës atë që iu mohua pa të drejtë e për një kohë të gjatë: atdhetarizmin e tij të spikatur.